

BESİMİ



* * *



Brahim Taçi

Therandë - 2011

Recenzent: Dr Sadri Fetiu.

Redaktor dhe Lektor: Ramadan Shala

Kopertina: Kreshnik Gashi

“Pranë veprës së Besimit,

Pranë shtatores së tij,

Edhe ky shkrim është një

Vepër me vlerë

Kushtuar HEROIT.”

Prill, 2011 - Prof. Ramadan Shala

* * *



Besim Ndrecaj

Dhoma e hetuesisë nuk ishte me më pak njerëz, apo persona të caktuar siç ndodhte zakonisht. 3 maji i

vitit 1995, ishte situata më e jashtëzakonshme për aq sa mund të mbanin mend milicët serbë, kuptohet ata të cilët kishin qëndruar një kohë të gjatë aty, realiteti po fliste tashmë ndryshe.

Në tavolinat përplot letra e dosje e gjithashtu paisje të tjera të nevojshme për milicinë, nuk kishin vend që të përshtateshin dhe të fillonte shqyrtimi i tyre, ngjashëm sikurse ishte çdo ditë punë e tyre.

Kjo tregonte se situata kishte eskaluar, nga ajo që me fanatizëm ngulë këmbë se gjithçka sistemi kontrollonte, kështu ata ishin mësuar, jetonin krenarinë në rrenc që jua kishte krijuar logjika e të quajturit të pushtetshëm, por tani nuk dukej ashtu, natyrshëm nuk ndodhte, si çdo ditë tjetër.

Rreth një tavoline të vogël qëndronin komandantët serbë të cilët po flisnin me njëri - tjetrin, të mbledhur shihin muskujt e fytyrës së tyre dhe përjetonin pushtetin e emocioneve nën ndejë të padurushme, nuk ishin parë të shihnin e të ndjenin së bashku përjetimin e befasisë.

I drejtoheshin me gisht njëri - tjetrit, diçka fshihej fillimisht, nëse tash për tash ishin të pakët milicët që e nuhasnin situatën brenda mureve të një stacioni i cili për herë të parë ndjehej i pasigurtë brenda vetës.

Bërtimat dhe të sharat e tyre dëgjoheshin qartë nga dhoma në dhomë e nuk dihej kush kë e akuzonte dhe pse?

Një frikë e shfaqur në fytyrat e tyre, ishte si sëmundje e cila i mundonte ata, sonatoriumi u krijua natyrshëm, të sëmurët e pushtetshëm e kuptuan identitetin e tyre.

S' ishte pamje e përditshme kjo për milicët e thjeshtë e të zakonshëm ishte ajo e cila nuk kishte ndodhur ndonjëherë, ata ndjeheshin tërsisht të burgosur në objektin e tyre. S'ishin mësuar të shihnin frikë tek komandantët e tyre, kjo për ta nuk kishte mundësi të ndodhte.

Në stacion gjithçka ishte për ta e madhërishtme, ata kontrollonin pothuajse gjithçka në jetën e njerëzve, ishin alfa dhe omega e gjithçkaje, ishin fillimi dhe mbarimi, por tash?

Ajo dhomë e vogël tashmë po stërmbushej dhe nuk kishte vend as në koridor e lëre më në dhomën ku pritej të jepej një urdhër.

Ishte krijuar një situatë rrëmuje, edhe pse nuk e kishin shpallur të jashtëzakonshme, ajo çdo moment po merrte një karakter të tillë, kuptohej se duhej të largoheshin nga ajo sepse kjo do të krijonte mundësinë që në famën dhe suksesin e tyre të dyshohej.

Në oborr veçësë kishin filluar të sillnin shqiptarë të torturuar, të cilët i sillnin dhe dërgoheshin menjëherë për në burg pa vepruar me procedura të rregullta të cilat do të duhej t'iu nënshtroheshin organeve të caktuara, për të vërtetuar apo jo fajsinë.

Ata ishin marrë në rrugë, shtëpi, dyqane, kudo, me një arsyje të vetme të çmendur nga frika e gjithçkaje që mund të quhej shqiptare.

Një situatë e papritur e kishte çorjentuar gjithë sistemin, dhe si rezultat i kësaj tashmë dhomat gjithnjë e më shumë mbusheshin me shqiptarë.

Të gjithë menduan në fillim se kishte ndodhur ndonjë demonstratë, por lidhur me këtë s'ishin paralajmëruar më parë, askush si kishte informuar apo ndoshta ka ndodhur gjithçka spontanisht, pa e ditur ne - i pëshpërisnin afër njëri - tjetrit milicët.

Papritur u dëgjuan fjalë, se dikush e kishte vrarë komandantin e stacionit SHOSHIQ.

Një lajm, i cili e ngriti në këmbë gjithë aparaturën shtetërore.

Kudo në rrugë shumëçka zëvendësohej, nga njerëzit e thjeshtë që në mënyrë të pavetë - dijëshme largoheshin e më pas zëvendësohej në milic e ushtarë, dhe nga zhurma e zakonshme e makinave të njerëzve, në tymin e zi të mjeteve të rënda policore e ushtarake serbe.

Thuajse për një çast koha u ndal, e shndërruar në një shfaqje tragjike nga e cila kishin frikë ta shihnin, por ajo ishte kudo pranë tyre, të gjithë e ndjenin kudo gjendjen e nderë, të hekurt, torturoese për shqiptarët, e vende vende mospërfillse për të tjerët të cilët donin pikërisht në atë moment të kuptonin të vërtetën.

Disa krisma diku lajmëruan thirrjen për mobilizim, krejtësisht të pasqaruar e pa organizim, nuk dinin përkushtimin, brenda pak minutash, realiteti ndrronte në formën e vet, shumë fjalë, shumë zhurmë, shumë pamje, frikë për ata që mendonin se s'frikësoheshin, pyetje, pyetje për të gjithë !

Si jashtë, ashtu edhe brenda stacionit ishte ngjarja e shpërthyer përnjëherë dhe befasuese, dikush u vra,

dhe jo dosido, një komandant i cili kishte famë në ndëshkimin e shqiptarve.

Ishte vrarë njeriu i cili muaj të tërë mbante nën kontroll shumë fshatra shqiptare të rrethit të Prizrenit e Suharekës, duke torturuar banorët për t'iu kërkuar armë. Dikush si duket nuk duroi, hakmarrjen thuajse e kishte të planifikuar

Kush mund të ishte ai ?

Mos e ka bërë ndonjë shërbim sekret? Pyesnin milicët njëri - tjetrin në koridorin e stacionit, të cilët hidhnin në panik hipotezat e tyre, ngase nuk dinin si të vepronin apo flisnin për çastin.

Këtë e kanë bërë shqiptarët, - ia priti milici me zë të shterrur i cili arsyetonte para kolegve të tij se këtë e dëgjoi nga eprorët të cilët i kishte përgjuar teksa po bisedonin në dhomën e caktuar të tyre, anipse kolegu i tij e shikoi rrept sepse kjo mund ta dëmtonte atë, e dinte se nuk ishte e lejuar.

Po çfarë shqiptari bre, ku kanë guxim ta bëjnë këtë ata - e injoruan kolegun e tyre, dhe në bisedë e sipër një epror me zë të lartë thërriti në koridor - "Të gjithë në dhomat e eprorëve tuaj, a kuptuat, asnjë të mos e shoh në koridor, pse jeni mbledhur të gjithë këtu...hajde çfarë shikoni, shpejt, shpejt... largohuni nga këtu ...

Ata u trazuan si minjtë duke u futur sa më parë në dhomat e eprorve të tyre, të hutuar nga urdhrat e shumtë që u ipeshin përnjëherë.

Eprori serb shtatëlartë pas disa minutash ishte vetëm në koridor, asnjë milic, i përzuri edhe pse për momentin nuk e logjikoi urdhrin e tij dhe nga situata

e cila e trimëroi duke iu thërritur milicëve, diçka e ngushtonte hapësirën e tij, matej e sillej i hutuar, kishte harruar nga frika se në cilën zyre të hynte, në mbledhjen e komandantëve të regjionit i dëgjoi fjalët e rrëfimet të cilat e çrregulluan emocionalisht.

Asnjëherë më parë nuk kishte hapësirë të pushtuar nga heshtja e frika se sa kjo ditë, ato ishin prezente kudo, përveq ndonjë zhurme e cila prodhonte panik brenda vet stafit të milicisë.

Pas kësaj filluan zërat e çjerrur të eprorve e komandatëve të cilët iu drejtoheshin milicëve - *“Brenda ditës e duam Besim Ndreçën këtu të gjallë, në këtë stacion, a kuptuat, mbane mend mirë Besim Ndreçaj”*.

Këta zëra ishin tortura psikologjike e eprorit në koridor. Ecte në mënyrë të pakontrolluar dhe thërriste më vete. *Besim Ndreçaj, Besim Ndreçaj...*

Një emër i njohur, shumë i njohur...e ndjente se e kishte takuar diku.

Dhe në çast iu kujtua, po po poo tha me vete: tash po e njoh, a mund të jetë ai? pyeste me zë dhe ndërdijsja e tij filloi të funksiononte:

“Disa vite më parë në fshatin Malësi e re, ky eprorë me disa milicë afër shtëpisë së Besimit kishin instaluar një punkt policor dhe po ndalonin makina e njerëz të atij fshati të cilët torturoheshin pa asnjë arsye. Kështu ishin urdhëruar që forma të tilla të kontrollimit të shtriheshin kudo në fshatra, urdhëri përmbante që kudo të krijohet pasiguri e frikë tek shqiptarët.

Papritur nga dera përballë tyre shfaqet një burrë shtatëdhur i cili pa ju trembur syri ishte drejtuar drejt tyre.

Njëri nga milicët përpiqet ta ndaloj, duke parë se ai po vinte drejt tyre, por Besimi me zë kumbues iu drejtohet - Cili nga ju është më i madhi?

Unë - iu përgjigj eprori me zë të ulët duke ruajtur pështymën në gojën e terur nga frika, i cili nuk po e kuptonte situatën psikologjike të krijuar tek ai dhe sjelljen e hutuar të milicëve.

Milicët tjerë habiteshin nga gjendja e eprorit të tyre, çuditshëm i transformuar nga njeriu i cili bënte presion tashmë përballë këtij burri i zbutur si dele.

Ndërsa me vëmendje dëgjonin dialogun mes tyre.

Besimi - ju jeni komandanti apo?

Eprori - Po, çfarë kërkonte ?

Besimi - Dua të di pse i maltretoni njerzit para dyerve të mija, të lagjes time. Kush ua jep këtë të drejtë?

Eprori - Po silleni si milicë, kujdes ne e kemi këtë detyrë e jo ju.

Besimi - E di unë e di.

Eprori - Ne duam ta ruajmë qetësinë sepse ne jemi pushteti i duhur për juve...

Besimi - Meqë është kështu, atëherë urdhëroni brenda, mos rrini në rrugë - me ironi iu drejtua eprorit.

Eprori - Jo ne nuk mund të hymë, jemi duke kryer punën tonë.

Besimi preras dhe me gisht drejt tij e urdhëron - Atëherë, keni kohë 5 minuta që të largoheni nga dyert e mija ose do të sillem ndryshe...

Më pas largohet nga ata dhe hyn në shtëpinë e tij, pa e zgjatur shumë me ta.

Eprori i hutuar nga kjo situatë mendohet tashmë nën peshën e frikës.

Milicët i drejohen duke e pyetur-ta arrestojmë ?

Jo - iu thotë prerazi milicëve.

Dhe si i hutuar vazhdon - duhet të largohemi nga këtu sepse mund të jemi të rrezikuar.

Të largohemi tani? - pyeti njëri nag milicët .

Në automjet thash, asnjë pyetje më shumë ... urdhëroi eprori.

* * *

Nga kjo ngjarje e zgjoi goditja gabimisht në krah e një milici të cilët si të çmendur u drejtuan nga oborri dhe me makina e mjete tjera të blinduara të ardhura nga Prizreni gjithashtu të përkrahur edhe nga helikopterët, shkonin në drejtime të ndryshme, të ipnin përshtypjen e një situatë lufte.

Për një moment u duk se stacioni u braktis kur u larguan ata, por nga minuti në minutë shumçka ndryshonte, sërish në oborrin e stacionit dhe në rrugët afër tij vinin makinat njëra pas tjetrës.

Brenda stacionit ishin pak milicë dhe eprorë të caktuar të cilët duhej patjetër të qëndronin aty, kjo duhej të krijonte baraspeshim në numër ngase situata ishte gjithnjë e më nderë.

Të gjithë në ndjekje shkuan pas një njeriu i cili për momentin ishte pak i njohur, por eprorët dhe komandantët kishin përshtypjen se ky njeri nuk ishte i zakonshëm.

Ngjarjet brenda kohës ishin të shpejta, ishin jo të rëndomta, si duket do të ishte ditë e cila do të mbahej mend shumë gjatë.

*

* *

Situatat e jashtëzakonshme ishin të shpeshta viteve të 90-ta. Të gjithë ndjenin se diçka duhej të ndryshonte. Të shtypurit ishin lodhur e pshtetur për muri, ashtu që vazhdimi i kësaj mënyre të jetesës ishte bërë i padurueshëm.

Megjithatë diçka lëvizte, edhe nën trysninë e një pushteti i cili synonte të mos lëvizte asgjë.

Por ky pushtet sado i tmerrshëm, çnjerzor e i frikshëm, sfidohet shumë lehtë në kohë të caktuara, atëherë kur atdhetarët po e kuptojnë se pikërisht ky sistem nuk është i fuqishëm sa duket, e pandalshëm po insistojnë që kjo situatë të ndryshojë shpejtë dhe në tërësi (të rregullohet).

“Liria po vjen, drita e saj veçse ka filluar të duket, ju duhet ta besoni, të punoni që rruga drejt saj të jetë më afër, përkushtimi për të”

Këto ishin disa nga paragrafet në një Gazetë Shqiptare të cilën nuk e kuptonte as vetë eprori pse e lexonte, dhe për çudi vazhdonte më tej: *“Era po fryn me shpejtësi të madhe gjithandej, dhe për të gjithë. Disi na kujton se duhet të dimë fuqinë e saj, ushtimën paralajmëruese që na ushton në veshët e secilit.*

Sytë tanë shohin kaosin e gjetheve dhe lëvizjen e tyre në drejtime të humbura disi, do të jenë rrugë të cilat nuk i dijm as ne.

Era po fillon, era s'do të ndalet, gjithnjë e më shumë fryen, gjithnjë e më shumë fishkëllen, kushedi sa do të ushtojë, kushedi sa do të thërret ?

Ne hutohemi pas pasurisë që do të dëmtohet si rezultat i kësaj ere që të gjithë e dijm se do të vijë një ditë, e megjithatë disa shpresojnë se do të vonohet.

Flitet e stërflitet shumë dhe përditë. Ishin munduar shumë kohë më parë ta ndalnin në shumë vende e shum popuj, por era s'ishte ndalur...

Ajo do të vijë këtu, e do të ndezë shumë zjarre, shumë tym do të pllakos vendin, njerëzit do të ikin nga njëri - tjetri, e në fund do ta vulos populli fatin e tij!

Apo ndoshta ka filluar, dhe nuk e dëshirojnë, ajo nuk duket apo ne s'duam ta shikojmë..."

Eprorit i dhimbte tmerrsisht koka nga ajo që e lexonte. I dukej ky shkrim herë si Mit e herë si Profeci, apo ndoshta nuk e kishte përqendrimin e duhur ta kuptonte më mirë se di pse trullosej nga kjo.

Dikush hyri pa paralajmërim dhe pa kurrfarë leje apo përshëndetje të zakonshme filloi duke ia transmetuar urdhërin se duhej urgjentisht të mblidhte gjithë dokumentacionin për Besim Ndrecën.

I tregoi edhe dosjet se ku mund t'i gjente, ngase ato përmbledhnin shumë vjet informacion për te.

Gjithashtu ia shqaroi se ky është urdhër i komandantit kryesor dhe se duhej të kishte shumë kujdes, por para se të largohej eprori e pyeti:

E arrestuat apo ?

Jo - iu përgjigj dhe vazhdoi më tej - fshati i tij është rrethuar, familjen e tij nuk e kemi gjetur më vonë e as atë, është larguar diku, atë do ta arrestojmë s'ka ku të ikë, edhe pse thonë se është shumë i rrezikshëm.

Tani më falni duhet të largohem, më thërrasin tek zyrja tjetër - dhe me goditje të fortë e ndoshta pa dashje e mbylli derën.

I rrezikshëm, interesant të gjithë po frikohen sot, thuajse na ka sulmuar një ushtri - i habitur pëshpëriste me vete dhe pa humbur kohë filloi t'i kontrollonte dosjet e tij.

E la gazetën mënjanë sepse ai artikull e kishte habitur, dhe donte të shpërqëndronte vëmendjen nga ai, dhe kontrollonte më tutje dosjen e tij.

Para dosjeve qëndronte i heshtur, edhe pse si duket dosjet nuk do të thenin heshtjen në mendjen e tij.

Duart i dridheshin, sytë i mjegulloheshin e zemra të dridhurat tash i kalonte përtej kufijve.

S'i kishte ndodhur ndonjëhere, që të ndodhte kështu, në kurrfar rasti.

Që ta parandalonte sado pak këtë, në raftin afër tavolinës vërejti rakinë dhe pa u menduar shumë u ngrit nga karrika.

E mori shishen dhe si i çmendur disa gota i gëlltiti, dhe kjo si duket e stabilizoi pak a shumë gjendjen e tij të cilën as vet eprori nuk e kuptonte.

Rrjedhshëm në mendje i paraqiteshin shumë zhurma, foto, situata që i kujtonte nga rastet e hetuesisë.

Tundi kokën që të kthjellohej pak dhe mendoi të ndezte një cigare. Ashtu veproji, e ndezi cigaren dhe pa paralajmërim hyri në milic.

I habitur kur e pa eprorin tha: Më falni mendova se nuk është askush, mund të marrë ujë sepse një i arrestuar shqiptarë është alivanosur.

Eprori pohoi vetëm me kokë, dhe milici e kuptoi miratimin e tij.

Eprori njihej në këtë stacion policor si njeri i qetë, por ndodhte që të talleshin ndonjëherë kolegët me të, dhe e quanin "Qullac", sikundër ky ishte i ardhur nga Beogradi dhe njihej si ekspert i hetuesisë, dhe kishte njohuri të shumta.

I ardhur menjëherë pas studimeve dhe i punësuar në këtë stacion nuk ishte edhe aq i mirëseardhur sa që disa nga eprorët e kishin porositur.

"Këtu s'ka se si të zbatojmë rregullore për shqiptarët, ata duan vetëm dru, po po ata s'duhet ti lëmë të qetë, ndryshe organizohen e mandej vaj halli për ne" - kështu ia kishin theksuar disa herë, sa herë që këtij eprori i dukej jo-njerzore tortura e milicëve e theksuar ndaj shqipëtarëve. Fjalët e milicit i cili hyri në zyrën e tij e kthyen prapa në kohë eprorin, e pa vehten para disa vjetësh në një situatë tjetër:

"Atëhere isha i ri, dhe shumë i ngazëllyer, doja sa më parë të punoja në raste të shumta. Por lodhja ishte e rëndë qysh në fillim, tjera rregulla, tjera kushte ishin në realitet nga ajo që kishte studiuar."

Dhoma ku qëndronte ishte e ftohtë, e errët, e mbyllur, kushte të cilat e bënë që edhe ajri të kishte frikë e të mos ndihej i lirë.

Në mes të saj ishte tavolina dhe dy karrige, një për të arrestuarin dhe tjetra ishte e pyetsit.

Në realitet nuk ndodhte kështu, tjetër shkruhej, e tjetër ishte.

E sollën një shqiptar pa vedije, i cili pasi i erdh vetëdija lëngonte nga të rrahurat të cilat i kishte përjetuar gjatë arrestimit.

Më lutej: Babain e kanë rrahur shumë, me mua bëni çfarë të doni, atë lirone sepse është i vjetër, s'mund tu bëj ballë torturave... ju lutem ...

S'mund t'i përgjigjesha, e as nuk dija si të veproja, por si duket ai e kuptoi heshtjen time, e nderpreu lutjen.

Pasi e mori vehten pak, fillova ta pyes:

- A e din pse të kanë sjellë këtu?

Rrudhi krahët por pas 7 apo 8 sekondash filloi të fliste - Nuk e di unë jam student i drejtësisë dhe në vikend erdha në shtëpinë time. Babain dhe dy vëllezrit e mi i kishin rrahur ditë me rradhë në këtë stacion policor, iu kanë kërkuar armë. Kjo si duket nuk ju ka mjaftuar, ata erdhën sot në mëngjes në shtëpi na morën babain dhe mua.

U ndal pak, po përbihej, dhe me këtë e kuptova se i nevojitej ujë.

I kërkova menjëherë milicit që të sillte ujë.

Si duket kjo e motivoi atë, dhe më pas vazhdoi të fliste - mua më arrestuan sepse më gjetën libra shqip dhe

indexin e Universitetit të Prishtinës. Më rrahën e më fyen deri sa më sollën këtu para jush”.

Vazhdova ta pyes :

Pse nuk iu lute familjes që ta dorzojnë armën më parë ?

- Ju thash më parë se studioj drejtësinë, dhe për këtë unë jam në këtë gjendje siç po më shihni. Ju s’keni fakte për të cilat më akuzoni....

Ndërkohë që fliste, njëri nga komandantët hyri si i çmendur, e solli plakun dhe filloi ti rrahë të dy. Ata mbroheshin për njëri - tjetrin dhe stoik i qëndronin torturave të milicëve dhe komandantit.

Dola jashtë sepse s’doja ta shihja atë skenë, e në koridor e pash milicin me gotë në dorë, me ujin që i kërkova më herët, u ndal më shikonte i hutuar por unë nuk munda t’i flas....”

Këto mendime ia ndërpreu zhurma e helikopterit nga jashtë, doli në koridor dhe një milic e njoftoi se Shoshkiq ishte tashmë i vdekur, u shtang, dhe përnjëherë e urdhëruan se duhej të siguronte sa më parë të gjitha dosjet për Besim Ndrecën, kohë kishte pak.

E pyeti: Ende nuk është arrestuar ?

Jo - iu përgjigj, dhe i lëshoi në duar disa dosje tjera dhe u largua.

Hyri në dhomë u ulë para dosjes të cilën duhej ta shfletonte, por edhe një ngjarje iu kujtua:

Sot qysh në mëngjes ky stacion nuk ishte i qetë.

Në një dhomë, Shoshkiq po fjalosej me një koleg të tij, ndërkohë ai po e porosiste :

- Meqë s'po dëgjon dhe po vepron në kokën tënde, po të këshilloj që të kesh shumë kujdes kur të takohesh me te, ai është i papara - shikueshëm, madje është shumë i saktë në gjuajtje me armë....

Por si duket Shoshkiq nuk e kishte ndërmend të merrte parasysh këshillën e tij, duke u larguar me milicët i thoshte kolegut :

- S'kam nevojë për kshillat e tua, qyqana jeni ju, s'jeni të zotët të arrestoni një shqiptarë, çfarë pritet nga ju, ti e din unë i kam çarmatosur e maltretuar gjithë këta njerëz në këto fshatra, e s'ka pas kush që më del përpara, tash edhe Besim Ndrecën para syve tu kam me ta pru. - deklarohet duke qeshur dhe iku me vrap.

Si duket është dashur të dëgjoj kolegun e tij, tha me vete eprori dhe filloi të lexoj një dokument me të dhënat e tij.

Në dosje kishte shumë dokumente të cilat ishin të regjistruara më parë.

Në dorë kishte një dokument, i shkruar kështu: *“Besim Adem Ndrecaj, nga fshati Maqitevë. Lindur më 10 Maj 1956. Nga fshati Maqitevë, vend i tij i lindjes, ai tani është nxënës në shkollën fillore të Mushtishtit “V.I. Lenin “.*

Si nxënës, vlenë të theksohet se është i suksesshëm në mësimet. Konsiderohet se mund të jetë i rrezikshëm sepse është i interesuar për Historinë e Shqiptarëve, e sidomos me entuziazëm mban mend dhe i reciton para nxënësve vjershat me përmbajtje nacionaliste... Udhëton nga fshati i tij i lindjes për në shkollën e Mushtishtit, Menduam se mund ta lë shkollën për shkak

të kushteve jo të mira mirëpo ai me përkushtim e vazhdon shkollimin”

Pasi e lexoi këtë dokument qeshi dhe pëshpëriti - fëmija nationalist i rrezikshëm hehe....

Vazhdon me dokumente tjera:

“Viti 1971. Ju kemi informuar se personi në fjalë Besim Ndrecaj, vazhdon të jetë i rrezikshëm për pushtetin. Është regjistruar në shkollën e mesme të Gjeodezisë në Gjakovë dhe vlen të përmendet se ai vazhdon të jetë nxënës i dalluar, por si duket ai nuk është i lëkundur nga bindjet e tij nacionaliste, edhe pse kemi futur e elementë që e përcjellin dhe mundohen ta parandalojnë në përhapjen e këtyre ideve të rrezikshme. Karakteri i tij është i fortë, duket i vendosur dhe bindës në të gjitha ato që i thotë .

Ju propozojmë

* * *

Të çmendur vërtetë janë të çmendur, mendonte me vete eprori.

Në zyrë hyri njëri nga kolegët e tij i djersitur. Duhet patjetër të gjejmë sa më shumë të dhëna, për këtë vrasës, ke gjetur diçka? - fliste me shpejtësi dhe mezi merrte frymë.

- Asgjë deri më tani - ia ktheu gjakftohtë eprori.

- Si asgjë? Duhet patjetër, krejtë shteti e milicia janë në këmbë, ta zën këtë shqiptar, ndërsa ti s’gjen dot dokumente.

- Ti e din, ke përgjegjësi për këtë.

- Çfarë përgjegjësie, kërkon dokumente që nxënsin ta krijoj kriminel - nxehet dhe përplas dokumentet në tavolinë.

Kolegu i tij i mblodhi dokumentet dhe filloi t'i lexonte për vete.

Ndërsa eprori i nxirë në fytyrë shikonte në dritare kohën e vranët dhe filloi të fliste:

- Ky njeri thonë se është i rrezikshëm, e unë në dosje po shohë një njeri të zakonshëm, ndërsa në pluhurin e këtyre vitrinave kam dosje ku nxënësit janë helmuar, dhe për këtë nuk keni ndërmarr asgjë, më dëgjon apo jo - i drejtohet kolegut të tij.

Ai e shikon preras i lëshon një dokument, dhe del jashtë.

Eprori fillon ta lexoj:

“1978. Është sulmuar me thikë Drejtori i Gjeodezisë në Suharekë nga Besim Ndreca. Pas një konflikti verbal, Besim Ndreca ka shprehur haptas bindjet e tij nacionaliste, në mbrojtje të të drejtave të punëtorve shqiptarë, e që kulminacioni i këtij konflikti arrin kur drejtori ka kërkuar nga ky të lëshoj vendin e punës. Kjo është përfunduar me lëndime të rënda për drejtorin serb. Ai është dënuar nga Gjykata Komunale për kundërvajtje në Suharekë, dhe”

* * *

Nga jashtë në oborr u dëgjuan zhurma të çuditshme, e për të parë këtë eprori doli nga dhoma e hetuesisë, nëpër koridor dhe pa oborrin përplot milicë ndërsa një komandant u fliste:

“Tash e dini, komandanti Dragan Shoshkiq është vrarë. Nuk më intereson si e kryeni këtë detyrë. Besim Ndrecën e dua të gjallë në këtë stacion. Tani shpërndahuni ...”

Ky urdhër i trazoi të gjithë saqë eprori mezi mundi të kthehej në dhomën e tij të hetimeve. Kudo tollovi e frikë, kjo kishte mund të ndodhte vetëm në gjendje lufte, e kush mund ta dinte, se çfarë mund të ndodhte gjatë orëve të ardhshme, ndoshta e papritura e krijoi këtë, por heret ishte të nxirrje një përfundim, pak dihej, shumëçka ndodhte.

Në dhomë i takoi dy milicë të cilët ishin në akcion më parë, dhe shfrytëzoi rastin ti pyeste.

- Ku e kërkuat ?

Tek sa armatosej njëri nga ata i sqaronte eprorit:

-“Ishim në shtëpinë e tij, kontrolluam mos është aty, djali i tij na tha se është në punë, shkuam edhe një herë kontrolluam mos është kthyer por jo. Ai ka ikur nga vend i punës në OBI- Suhareka, pasi atje ka shkuar Shoshkiq, t’ia marrë armën, por ai e ka vrarë atë, dhe plagosur të tjerë. Me shpejtësi ishte larguar nga aty, kështu i kemi informacionet por ne ende po e kërkojmë, ai s’mund të largohet askund, ose në shtëpi do të vijë ose mund ta gjejmë në fshatrat përreth. Ka forca të shumta, i gjithë shteti është vënë në ndjekje të tij. Tani a mund të largohemi sepse na kërkojnë” - përfunduan kështu rrëfimin e tyre.

- Po - iu përgjigj eprori.

Sërish i vetëm. Këto ditë dhoma e hetimeve pothuajse ishte shndërruar në burg për eprorin. Nuk mund të

përcaktonte se kur është mëngjes apo mbrëmje. Me ditë të tëra i mbyllur në mes dosjesh, me situata e skenare të cilat thuajse e kishin çmendur nga sajimet dhe të pavertetat të cilat mund ti prodhonte vetëm ky sistem. Prap e ndezi një cigare. Tymi krijonte imazhe të cilat i ngacmonin memorijen të kthehej në kohë mbrapa, çdo sjellje e veprim si duket e detyronin të kujtonte diçka.

“Më informuan se sot duhet të shqyrtoj dosje të ndryshme, mirëpo për këtë duhej që tërë ditën ta kaloja duke pyetur persona të ndryshëm.

Ndër të tjerë, më bëri përshtypje një njeri i cili kishte deklarata të çuditshme.

Atë e kisha thirrur të parin sepse isha kureshtar ta njihja sa më afër.

Ai nuk u vonua, erdhi i sakt në kohë, trokiti njëherë dhe në pamjen e parë mu duk njeri intelektual, mirëpo nuk erdhi i vetëm, atë e shoqëronin edhe puntorë të tjerë të sigurimit, të cilët ma prezantuan me fjalë miradije, duke arsyetuar se kishte kontribuar shumë viteve të fundit për shtetin tonë, e quanin dinak me përkëdheli, sepse ishte praktik në situata të ndryshme.

U ulë në karrige, dhe filloi të qeshte duke më ofruar cigare.

Nuk ia vëra veshin dhe kërkova që të mos e ndezte, e paralajmërova se duhej ti respektonte rregullat.

Njëmend kishte sjelljen e dhelprës, ju bind menjëherë urdhrit tim, edhe pse nuk ishte mësuar kështu me të tjerët ta trajtonin në këtë mënyrë.

Fillova ta pyes pse keni ardhur, ose më sakt çfarë dëshmoni?

Filloi të ndryshonte në fytyrë por sytë e tij të zbehtë e kuptuan menjëherë vështrimin tim ironik, hapeshin e mbylleshin duke mos krijuar siguri, ngase edhe kështu e vëreja pasigurinë e tij për ta thënë të vërtetën.

Gjithashtu frymarrja e tij e pakontrolluar tregonte mënyrën për të manipuluar shumë gjatë marrjes në pyetje, dhe me gjithë këto vështirsi filloi të përgjigjej :

- Unë shumë herë i kam shërbyer këtij pushteti të mirë, këtij pushteti të duhur për shqiptarët sepse ne historikisht...

E nderpreva - ju jeni shqiptar apo?

- Po por - donte të manipulonte spiuni.

- Më thoni konkretisht çka doni të deklaroni, me krahasime e analiza ka kush të merret.

Sytë filluan t'i skuqeshin dhe tani filluan ti dridheshin edhe duart, nuk e dija a e kishte nga cigarja apo nuk ndihej i sigurt me mua ndërkohë vazhdoi:

- Mua më kanë obliguar që t'u informoj gjithçka që kam dëgjuar.

Më konkretisht mund t'u shpjegoj.

- Vazhdoni, vazhdoni - doja t'ja shpejtoja rrëfimin sepse kështu ndoshta mund ta zbuloja. Uli kokën njëherë dhe filloi - Për personin të cilin do të tregoj është Besim Ndrecaj, por ju lutem mos e shkruani emrin tim sepse ai është i rrezikshëm dhe mund të më hakmirret, thonë se edhe milicia nuk guxojnë t'i afrohen. Para një jave ishim në një odë, aty u kënduan këngë patriotike dhe u fol nga studentë të ndryshëm të fshatit dhe të ardhur

nga anë të ndryshme të Kosovës, për organizimin e popullit kundër pushtetit aktual serb por nuk munda t'ua mësoj emrat e vërtetë sepse flisnin me Nofka.

Aty erdhi edhe një burrë i hedhur, i madh me mustaqe të zeza, për atë thonë se ka armë dhe e mban me vete kudo. Thash, t'ju tregoj sepse kjo sigurisht ju duhet...

- Shumë paske zbuluar i thashë dhe vazhdova, - studentët i ke parë, por s'di gjë për emrat, këtë Besimin e paske zbuluar se paska armë phiiiiii.

Mund të shkoni nëse nuk keni asgjë për të thënë - i thashë prerazi.

Si duket këtë e priti më së shumti, u largua kokëulur pa e thënë asnjë fjalë.

Vërtet njeri i çuditshëm, mendova.

Për të "çuditshmen" time, kishim biseduar me kolegë disa herë.

U kisha bër pyetje se si është e mundur të ketë informator shqiptarë të cilët spiunojnë për shqiptarët, madje shumë prej tyre as që paguhen ?

- E kemi zhgjedhur metodën e duhur ... fliste duke qeshur njëri nga milicët meqë doja ta zgjeroja bisedën më shumë në këtë çështje.

Ata mundoheshin të arsyetoheshin se kinse shqiptarët e kanë shumë të lehtë të tregojnë për njëri - tjetrin, ndërsa unë kisha takuar në mes tyre të cilët ishin të palëkundur në atë që e mendonin.

E tregoja rastin para tyre të një gazetari shqiptar të cilin e sollën në stacion të përgjakur nga torturat e policëve, nën pretekstin se shkrimi i tij në një gazetë kishte përmbajtje nacionaliste.

Dhe rezultati ishte krijuar në atë mënyrë që gazetari brenda bisedës informative, na kishte mbajtur një ligjeratë të mirë për liritë dhe të drejtat e njeriut. Kur gazetari fliste se si ishte shkatërruar dhe në çfarë rruge tani është Jugosllavia, pastaj shprehte në mënyrë të hapur se diktatura siç po e quante gazetari “Diktatura e Millosheviqit” do të jetë vetëm sistem i cili do të prodhohj luftëra në Ballkan ...

Unë dhe të tjerët mendonin atëhere se ky mund të jetë ose i çmendur ose njëmend di më shumë se ne.

Ne ishim zinxhiri i këtij sistemi i cili kishte komoditet të krijonte çfarëdo situatë kudo në secilën Republikë, e lëre më për shqiptarët ku tek të cilët kontrollonim gjithçka. Doli e kundërta sepse shqiptarët jo vetëm që flisnin për këtë shkatërrim por sipas informacioneve tona ata si duket po organizohen për diçka të madhe.

Se kisha imagjinuar se mund të bisedoja kaq lirshëm e hapur me komandantët për tema të tilla të cilat shpesh herë konsideroheshin të lehta fare të lehta, sepse me shqiptarët me pak dhunë policore dukej se gjithçka përfundonte.

Brenda kësaj sigurie imagjinative realiteti dukej krejtësisht ndryshe. Siguria jonë nuk kishte peshë të madhe, dhe mjaftonte një shkëndijë drite tek shqiptarët që ajo ta thente hijën tonë të madhe. Njëmend, mendoj ndonjëherë se në këtë vend jemi vetëm hije, hije që bredhin, hije që ndoshta dikur do të ikin....”

Sillej vërdall dhomës, thujse qëndronte në burgun e hijeve. Para raftëve rrinin dosjet, të cilat qëndronin vite e vite, të palosura njëmend sikurse vitet.

U afrua, sepse ato letra të jepnin përshtypjen sikur prodhonin zëra që kërkonin sqarim për të vërtetën.

Puna e tij i dukej më e rënda, ai duhej t'i deshifronte ngjarjet. Koka e tij zinte nga shumëllojshmëria e zhurmave.

Truri i tij ishte thujse arkivë i një festivali teatrosht ku ruheshin skenaret e ngjarjeve si të torturave të studentëve, helmimit të nxënësve shqiptarë, rrahjeve të pakontrolluar të protestuesve shqiptarë, terrorit në një fshat kudo në Kosovë me pretext të kërkimit të armëve etj.

Duhej t'i lexonte patjetër, dhe gjithsesi patjetër të krijoj raporte që i përshtaten politikës. Pse e zgjodhe këtë profesion? pyeste vehtë.

Në tavolinën e vogël ishte e hapur një ngjarje e madhe. Mumentalisht dihej që Besim Ndrecaj ka vrrarë Dragan Shoshkiqin.

Dosja e hapur, dokumentet raportet e shumë të tjera presin ti lexoj truri i këtij eprori të "burgosur".

"E konsiderojmë të rëndësishme të ju informojmë se Besim Adem Ndrecaj nga Maqiteva e Suharekës është personi ende i vëzhguar nga ana jonë. Menduam se shërbimi në ushtri do ta dicitlojë por si duket këtë person është e vështirë ta nënshtrosh.

Në Divule të Kroacisë pikërisht në vendin ku ky e kryen shërbimin ushtarak, ka ndodhur një konflikt.

Oficeri serb është sulmuar nga ana e tij pasi që ky i fundit ka deklaruar se është sulmuar verbalisht një bashkombas i tij (shqiptar), pas kësaj ai është përleshur me oficerin dhe dy ushtarë të tjerë serb, ku oficeri është lënduar rëndë dhe ushtarët kanë pasur lëndime të lehta. Gjatë hetuesisë është treguar i vendosur në deklaratat e tij, dhe gjithashtu vlen të theksohet që ende vazhdon të shprehë haptas kundërshtimin e tij ndaj shtetit serb. Ai është dënuar me 21 muaj burg dhe tani vuan dënimin në burgun e Lepogllavës së Kroacisë. Në burg e përshkruajnë si person të disiplinuar, të heshtur por që personeli i burgut e mbajnë të distancuar ...”

Lëshoi këtë dokument dhe mori një tjetër që si duket e lidhë ngjarjen e radhës.

“1981 - 1982 - Është liruar nga burgu i Lepogllavës së Kroacisë. Nuk është regjistruar ndonjë ekces i rëndë. Sipas gardianëve, atyre të cilëve dinin shqip, ai herë pas here këndonte këngë me përmbajtje nacionaliste e gjithashtu edhe recitonte. Kemi hulumtuar mbi ato vargje dhe është vërtetuar se ato janë vargje nga libri “Lahuta e Malsisë” të një shkrimtari shqiptar Gjergj Fishta. Ky libër konsiderohet i rëndësishëm të shqiptarët si libër i cili i frymëzon me ndjenja atdhedashurie. Kemi gjithashtu një informacion, se gjatë një vizite në burg të cilin ia ka bërë familja, rojet e burgut nuk e kanë lënë të hyjë ta vizitojë nëna e tij, me arsyje se nuk ka pasur dokument identifikimi. Kjo e ka revoltuar Besim Ndreçën, por më pas është qetësuar nga babai dhe daja i tij. Edhe pse konsiderohet i

rezikshëm, rojet dhe personeli e përshkruajnë si njeri të afërt por gjithashtu me parime të forta”.

I dukej interesant, e rrallë që një njeri i vetëm ta sfidonte një mekanizëm i cili lavdërohej kudo për efektshmëri e autoritet.

Mori gjithashtu një dokument tjetër, të lexonte, piu një gotë ujë dhe vazhdoi:

“Është punësuar në ndërmarrjen OBI-Suhareka, aty ushtron detyrën e Gjeodetit. Nga personeli nuk ka ankesa. Kemi informacione nga burime të ndryshme se Besim Ndrecaj bart revole pa autorizim, nuk kemi të regjistruar ndonjë konflikt, por duke pas parasysh personalitetin e tij të fortë, bartja e revoles mund të jetë e rrezikshme për policinë dhe organet tjera të rendit. Vërehet një siguri e madhe nga ana e tij, e gjithashtu kjo është reflektuar në popull gjë që tash nga veprimet e tij kanë filluar të kenë siguri edhe shqiptarët...”

Këtë e lexonte duke ecur nëpër dhomë, duhej gjithsesi t’i përfundonte së lexuari sot, ngase dita më e gjatë do ta quante, me tërë këtë presion e zhurmë të cilën e kishte shkaktuar tashmë personi i shumëkërkuar Besim Ndrecaj.

Në dy fronte kërkohet dhe të dyja të vështira për ta përthekuar e zbrapsur madhështinë e jehonën që do të ipte kjo ngjarje.

Me ngulm dokument pas dokumenti e shfleton figurën eprori i mbyllur mes dosjesh, e nga jashtë qindra milicë e shërbime tjera të sigurisë, të gjithë të përgatitur ta parandalonin vrapimin e Besimit drejt përjetësisë.

Jashtë kësaj dhome, gjithçka ishte në lëvizje, nga një situatë e mbyllur në qetësinë e padurushme e cila tmerronte qytetarët e pafajshëm, torturonte jetën e përditshme të njerzve të cilët kërkonin shpresë ta thenin shpejt e fuqishëm pllakosjen e frikës.

Sytë e tyre drejtoheshin kudo ta shihnin vrapimin e tij maratonik, e hapave të cilët na hapte horizontet ta shihnin më mirë të ardhmën, të një hapsire të cilën do ta pushtonte fuqishëm drita, e ngadalë do ta ndjenim ajrin e lirë të bjeshkëve të larta të Sharrit.

Besimi vraponte shpejtë e pas tij thujse era kudo shpërndante lajmin e një ngjarje që s'do të harrohej nga brezi në brezë.

Çdo hap i tij ishte gjurmë në tokën të cilën e kishte marrë malli për marshim lirie, për përballje trimash, për krisma që do të thenin heshtjen e maleve.

Beteja jashtë veçse kishte filluar, e brenda stacionit eprori serb shfletonte e mes rreshtash lexonte. Përbinte cigare, cigare kushedi se sa, i hutuar s'mund ta kuptonte cili ishte sekreti i një njeriu i cili fuqishëm po sillte argumente në luftë mes letrash.

Besimi po vazhdonte luftën fuqishëm e pandalshëm në dy fronte, nuk dorzohej as para makinerisë serbe as para hetimeve të eprorit i cili thujse po shkruante i pari historinë e tij.

Dokumenti i radhës i kishte futur të dridhurat, ja se çfarë po lexonte:

“1982. Ju kemi informuar edhe më herët për armëmbajtje pa leje, dhe se armën e bart me vete kudo që shkon megjithëse nuk kemi të dhëna ta ketë

përdorur për qef apo gjuajtje lartë në ndonjë dasëm apo aheng familjar siç ndodh në zakonet e shqiptarëve. E kemi përcjell kudo dhe me kujdesin më të madh kemi analizuar çdo veprim të tij. Deri më tani askush nga milicët nuk ka marrë guximin fillestar për ta ndaluar Besimin. Flitet se ai ka kërcnuar se nëse dikush nga milicët serb tenton t'ia merr armën, ai do të hakmerret, dhe kjo mbetet arsyeja pse deri më tani nuk iu është konfiskuar arma. Paraprakisht kemi hulumtuar veprimet e tij, lëvizjet kontaktet me të tjerët, por diçka e veçantë nuk është vrejtur. Ai rri i heshtur, i përmbajur, megjithëse konsiderojmë se nuk është edhe aq i qetë kur ai ndeshet me ndonjë padrejtësi. Është përhapur gjithnjë informacioni se Besim Ndrecën nuk guxon ta arrestojë milicia. Kemi menduar ta bëjmë një plan operativ për ta arrestuar, por.....”

Në shfletimin e këtyre dokumenteve ju kujtua se duhej patjetër të merrte shënime. Më se i koncentruar filloi të shënonte detajet ngase tashmë ngjarjet kishin marrë rrjedhën e caktuar.

Milicët hynin e dilnin nga dhoma por ai nuk i shikonte. Ishte i fokusuar në dokumentin të cilin tani po e lexonte dhe i cili po mbante shënim datën e njejtë të vitit 1982.

“Ashtu siç ju kishim informuar edhe më parë ne planifikuam planin operativ në koordinim edhe me organe tjera operative. Ne gjithashtu posedonim të dhëna të sakta për lëvizjet dhe veprimet e tij, për orarin e punës, takimet me njerëz të ndryshëm etj. Për ne kjo ishte përparsi e madhe sepse kështu ishim më afër

mundësive për ta arrestuar. Ai takohej çdo ditë, me shumë njerëz dhe kjo pak a shumë na ç'orientonte për ta përcaktuar shoqërinë e afërt të tij. Çdo ditë kemi pasur pothuajse mundësinë ta arrestojnë, por kanë dështuar nga pakujdesia dhe frika e pakuptimtë nga ana e milicve. Edhe pse nuk mund të arsyetohet joefikasiteti i tyre, mund të thuhet se ky njeri imponon frikë, duke pas parasysh karakterin e tij të fortë, dhe të mprehtë.

Shembujt e mëparshëm kanë treguar se ai është i rreptë dhe këmbëngulës në qëndrimet e tij. U analizuan mundësi të shumta për të paralizuar veprimet e tij. Pas diskutimeve dhe shqyrtimeve erdhëm në përfundim që arrestimi duhet të jetë shumë i thjeshtë dhe i papritur. Duhet të gjejmë mundësinë që veprimi jonë të jetë i shpejtë, i kujdesshëm dhe në përmasa shumë të vogla, pasi që menduam se arrestimi i tij duhet të jetë i mbyllur dhe jo i hetuar nga të tjerët. Detajet kanë treguar se kjo është e vështirë të bëhet. Sidoqoftë, ne do t'u informojmë për të gjitha veprimet tona. Kemi menduar që të koordinohejmë edhe me sektore dhe njësi të tjera të cilat veprojnë në rajonin tonë”.

Dokumentin e rradhës të cilin e kishte në duar nuk ishte i hapur, i mbyllur në një zarf, dhe për çudi aty shkruhej se duhej ta lexonin persona të caktuar. Tashmë kishte kaluar kohë e gjatë dhe mund ta lexonte edhe eprori.

Megjithëse dukej qartë se ky dokument ruante një sekret. Me padurim e qeli zarfin, nxori letrën dhe filloi të lexonte:

“Edhe pse për këtë aksion ishim përgatitur kohë më parë nuk doli i sukseshëm. Mund ti numërojmë disa faktorë, që e vërtetojnë joefikasitetin, por që ndoshta kjo nuk do ta justifikonte punën e njërive dhe të sektorve të milicisë të cilat kanë qenë në veprim atë ditë. Ndonse ne ishim përgatitur kohë më parë nuk rezultoi i saktë në arrestimin e tij. Menduam se pikërisht stacioni i autobusve në Suharekë do të ishte vendi i duhur ku mund ta arrestonim, ngase kishim analizuar me përpikmëri operacionin, por që në fund nuk doli të ishte i saktë ky veprim. Atë ditë ai ecte ngadalë dhe të ipte përshtypjen e një njeriu të lodhur, anipse ne e njihnim ecjen e tij gjithsesi, por na u duk disi më i lodhur se tjera herë. Operacioni ishte i organizuar në çdo detaj ashtu që gjatë arrestimit të mos ishin të pranishëm shumë milicë, dhe se ngjarja duhej të zhvillohej atëherë kur kishte më së paku njerëz afër tij. Kishim përshtypjen se mund t’i ndihmonin ngase ky ishte njeri i shoqërueshëm dhe gëzonte autoritet tek rrethi ku jetonte. Mirëpo, momenti erdhi në kohën dhe vendin e duhur. Në aksion menduam të merrnin pjesë 3 veta: 2 milic dhe një epror, shtesë 2 milic civil që duhej të ishin në rreze veprimi më larg, ndërsa ne duhej të mbulonim me informacion çdo çast të ngjarjes e cila po rridhte me emocione të forta.

Ai erdhi. Për një moment ne u mobilizuam të gjithë të hidheshim në veprim. Ne e prisnim disa orë që të vij ai deri tek caku ku ne e prisnim. Në fillim vrejtëm se ai nuk po din asgjë rreth aksionit tonë, dhe kështu duhej të ndodhte, ngase operacioni bazohej në numër të caktuar

dhe domosdoshmërisht ishte sekret, sepse kështu ishte caktuar nga organe të tjera, të cilat na urdhëruan që operacioni gjithsesi të ishte sekret.

Më në fund gjithçka duhej të fillonte, ashtu siç ishte planifikuar. Përpara i del eprori dhe e urdhëron të ndalet. Pas tij veprojnë milicët të cilët e kapin dhe tentojnë t'ia vënë prangat por... Diçka jo e zakonshme ndodhi, që na paralizoi akcionin. Nuk mund të besoni, dhe as ne të cilët e vëzhgonim situatën, mbetëm syhapur kur pam se si u ndryshua realiteti krejtësisht. Si besonim syve tanë që Besim Ndrecaj me zhdërvjelltësi arriti t'i largoj, dhe për pak sekonda ata u dorzuan para tij.

Ai me revolen e tij arriti të dorzonte. As milicët e tjerë e as ne nuk kishim guxim të afroheshim. Ai e morri situatën krejtësisht në duart e tij, i urdhëroi që me duart lart të vazhdonin në drjetimin të cilin e përcaktonte ai.

Dështoi edhe mundësia që aksioni ynë të dukej i fshehtë dhe pa rënë në sy të popullsisë. Brenda pak kohe kjo gjendje u diktua dhe njerëzit gjithnjë e më shumë grumbulloheshin. Kjo situatë sigurisht se u ka dhënë zemër shqiptarve, e në dy anët e rrugës njerëzit shikonin me habi veprimin e Besim Ndrecës tek sa i kishte dorzuar eprorin dhe milicët e tjerë gjë të cilën për momentin nuk mund ta konfirmonim se në çfarë drejtimi do t'i dërgonte ai. Por pas pak mundëm të kuptonim se i dërgonte në drejtim të stacionit të milicisë në Suharekë. Megjithatë distanca mes stacionit të autobusve dhe stacionit të milicisë është

rreth 150 - 200 m, siç dukej kjo ishte rruga më e gjatë dhe më poshtëruese për milicët serbë.

Ata vazhdonin para ndërsa Besim Ndrecaj pas tyre i urdhëronte, e disa herë eprorin e kërcënonte me fjalët - "S'është bash kollaj me ja marrë shqiptarit armën, mos harroni keni punë me Besim Ndrecaj" - dhe kështu në forma të ndryshme duke i poshtëruar i dërgoi deri në oborrin e stacionit të milicisë.

Më pas aty ka kërkuar Komandantin e stacionit megjithse nuk e ka njohur, por u ka thënë rojeve që ta thërrasin komandantin e tyre.

Aty është paraqitur Komandanti i atij stacioni dhe i habitur nga kjo situatë, ku më pas sipas dëshmitarve tanë Besim Ndrecaj i është drejtuar me këto fjalë për aq sa kemi mundur të vërtetojmë: "Merri këta klyshët e tu edhe mos t'i shohë të më dalin më përpara, kësaj radhe ti dorzova të gjallë, por po më dolën edhe një herë, s'besoj se do ti shohësh më ". E vën revolen në brez, dhe vazhdon rrugën e tij. Është situatë e veçantë për të cilën vështirë se mund të na besoni, por e kemi po aq të vështirë edhe ne sa të shkruajmë një raport rreth kësaj ngjarje. Kemi ardhur në përfundim që të mos marrim masa fillimisht ngase nuk kemi se si ta justifikojmë mosefikasitetin tonë para organeve më të larta, por propozojmë që kjo ngjarje të harrohet sa më shpejtë, Por gjithsesi ne kemi shpresa se".

E goditi me grusht tavolinën dhe thërriti - këto letra do t'më çmendin. Mbuloi kokën me duar dhe fliste me vete - kaq i pakapshëm paska qenë, dhe për çudi vazhdon të jetë i tillë, ngase ende nuk është arrestuar

edhe pse ka vrarë. Çfarë sistemi efikas mund të jemi ne, kur nuk kemi zotësinë ta paralizojmë veprimin e një shqiptari, ndërsa nëpër takime në Beograd fryhen si gjela se ata janë të zotë dhe e kanë dëshmuar këtë.

Me nervozizëm e morri dokumentin tjetër i cili ishte i palosur me delikatesë ku sqaronte kështu:

“1981 - Nga të gjitha vendet e Kosovës dhe Metohisë, raportohet se është situatë e tensionuar. Edhe pse i gjithë sistemi ynë është në lëvizje për ta paralizuar mundësinë e shpërthimit eventual të ndonjë trazire. Vërejmë se ende ekziston mundësia që shumë studentë shqiptarë po gjejnë mundësinë që në forma të ndryshme të organizohen për të protestuar në mbrojtje të të drejtave të tyre, por që vlen të theksohet se kjo paraqet rrezik për pushtetin ngase elementë të tillë janë nacionalistë të cilët nxisin shkatërrimin e Jugosllavisë, e mandej si zhgjidhje të vetme ia paraqesin bashëkombasve të tyre bashkimin me Shqipërinë. Rasti i Tahir Mehës në fshatin Prekaz të Skenderajt në Drenicë, u ka dhënë mbështetje morale. Por si ngjarje ajo po vazhdon që të jetë diskutim e frymëzim për rezistencë nëpër oda ku ata rrinë mbrëmjeve e shtëpi - shkolla ku ata zhvillojnë mësim. Kudo bisedohet e diskutohet në çdo detaj si për këtë e për çdo ngjarje e cila i ngjanë në përmbajtje. Me theks të veçantë ju informojmë se personi në fjalë Besim Ndrecaj e ka vizituar fshatin Prekaz të Komunës së Skenderajt, sapo është informuar për rezistencën e Tahir Mehës. Si duket nuk i ka mjaftuar pjesëmarrja në demonstrata të ndryshme e për të cilat disponojmë

edhe fotografi e materiale të tjera të cilat i kemi në pjesën përcjellëse më poshtë, ai ka vizituar pikërisht familjen e Tahir Mehës. Pas kësaj vizite ai u ka folur miqëve e këdo që ka takuar, për trimërinë e heroizmin e kësaj familje siç është shprehur ai. Na intereson të dimë e të kemi sa më shumë informacione se çfarë e ka tërhequr ta vizitoj këtë familje, dhe cilat do të jenë aktivitetet përcjellse të tij ...?”

Donte të ndizte një cigare, por e pa se nuk kishte. Më pas doli nga dhoma.

Në oborr pa tollovi, pa se kishin ardhur edhe ushtarë. Kushedi se çfarë do të ndodhte dhe si do të përfundonte kjo ditë e sotme.

Në këto momente luante rolin e përgjuesit të kuptonte se çfarë është bërë me Besim Ndrecën.

U afrua tek një makinë dhe po dëgjonte këto fjalë:

- E kemi të palgosur një milicë, por ai ende s'është dorzuar dhe vazhdon të gjuaj nga pozicioni i tij. Qetësi qetësi, se më duket kemi lidhjen drejtëpërdrejt nga vendi i ngjarjes. Marrje, marrje, si është situata tani - pyeste njëri nga komandantët në radio-lidhje, teksa filloi t'ia lëshonte zërin për ta dëgjuar të gjithë që ishin present në makinë.

Nga radio-lidhja dëgjoheshin këto fjalë të milicistit:

Jemi në distancë më pak se 100 m, por nuk po mund të afrohem, ai gjuan në drejtim tonin, deri më tani i kemi provuar të gjitha armatimet.

Në bazë të vëzhgimit tonë, mendojmë se është i plagosur, por ende nuk dorzohet. Se besojmë se ka armë tjera përveç revoles. Presim urdhrat tuaja.

Komandanti e urdhëroi - vazhdoni të insistoni me çfardo metode që ta zini të gjallë, a kuptuat në çdo rrethanë duhet ta zbatoni këtë.

Gjithashtu mos lejoni që t'i afrohet shtëpisë së tij, atje kemi gjetur armatim, por nuk jemi të sigurt, e ndoshta mund të ketë ndonjë vend tjetër, ku ai mund të ketë fshehur armatim a dëgjuat, marrje marrje....

Nuk kishte mundësi të qëndronte më aty sepse e pa se mund të diktohej dhe se tollovia e krijuar mund të prodhonte çfarëdo lloj situatë.

Shumë shpejt i mori cigaret, të cilat ia solli roja, dhe shkoi në zyrën e tij të vazhdonte punën.

Hyri në zyre. La cigaret mbi tavolinë, dhe vështronte arkiven në raftin përballë tij. I ra në sy "Artikuj e shkrime në Gazeta të ndryshme". E tërhoqi materialin sepse donte të pushonte pak nga stresi apo më saktë nga frika të cilit i krijonte pasiguri megjithse i rrethuar në oborr me milicë e ushtarë serb, pastaj brenda një stacioni policor, ku edhe dritaret kishin grila. Mirëpo frika depërtonte, pushtetin e saj se ndalonte ky rrethim i hekurt e ku në mes gjendej eprori.

Brenda kësaj dhome kishte diçka tjetër. Aty flisnin faktet, ngjarjet fotografitë, dëshmitë, intervistat, artikujt, ku brenda tyre ishte realitet tjetër, botëkuptim tjetër.

Në mes letrash ngjarjet e faktet ishin kokëforta, ato s'friksoheshin nga torturat, britmat e poshtërimet etj.

Hulumtimi i mëtejshëm i kësaj dosje vazhdonte:

"1989 - Me gjithë metodat e aplikuara të cilat na keni sugjeruar, pak po tregohet sukses në teren. I gjithë

angazhimi ynë po kthehet përkundrazi me te njejen medalje me aktivite të tyre. Besim Ndrecaj, kudo nëpër tubime po shpreh hapur kundërshtimin e tij për ndryshimet kushtetuese aty kur po diskutohet politikisht, rreth kësaj. Edhe pse i heshtur, e në fillim jo dhe aq i dhanun për të diskutuar, ai kur flet, të gjithë e dëgjojnë, kemi përshtypjen se është bindës në fjalimet e tij...”

Pushteti i fjalës së shkruar, sado i thjeshtë në dukje vërteton e flet më shumë nga ajo thuhet. Besim Ndrecaj, tashmë në këtë moment është në betejën e hekurt dhe sfidon sistemin tonë - mendonte eprori.

Mirëpo ai është i ruajtur edhe në arkivat tona, dhe tani na sfidon edhe më shumë, ai sot na ka shpallur luftë në dy fronte.

Në tjetër dokument shkruan kështu:

“1990 - Situata nuk është askund e qetë, anipse i kemi në veprim të gjithë mekanizmat për ta qetësuar atë. Ngjarja me nxënësit e helmuar i ka tronditur shqiptarët. Kemi vënë në veprim njësitë e intelegjencës e spiunëve në popull që ta mohojmë këtë por situata është tani jashtë kontrollit. Besim Ndrecaj e të tjerë kanë deklaruar në shumë vende se do të hakmerren. Meqë jemi në dijeni të posedimit të armës së tij revolver, e kemi kujdesin maksimal për mundësinë e veprimit të tij. Kemi informacione se ai është i interesuar që të blej edhe një automatik e armë të tjera, provat që i kemi nuk na mundësojnë veprimin konkret ...”

Çfarë në të vërtetë e ka bërë këtë njeri të jetë kaq i guximshëm, dhe të besoj se ka të drejtë të na

kundërshtoj, megjithse sigurisht e din se jemi më të fortë për mijëra herë, apo s'don t'ia di për këtë?

Pse pikërisht e ka zgjedhur këtë rrugë, këtyre pyetjeve ndoshta do t'i përgjigjet ky shkrim të cilin e kishte në duar eprori.

U mendua që ta hap edhe dosjen e helmimit të nxënëve por për momentin u koncentrua në këtë shkrim i cili mesi lexohej nga lagështia të cilën e kishte marr letra:

"Kishte pak rreze dielli, dhe ato vinin shumë vonë, kur gati pothuajse kalonte pranvera, apo më mirë të përshkruaj se rrezet e diellit ishin por njerzit nuk i shihnin ato, ashtu siç u kishte hije të shpërndaheshin arave, lëndinave, të shkrinin borën në majat e maleve, e dëshirueshme por e ngadalte, ndoshta ende nuk ishte koha që rrezja e diellit të pushtonte tokën. Kjo do të kujtonte dimrin. Acarin e muajve t'kaluar, fishkëllimën e padurueshme të erës, zjarrin në oxhakun e odës, heshtjen e plakut pranë saj, syt e pikëlluar e t'përplotur të nënave, vajin dhe urinëe fëmijëve. Në kasolle si brenda dhe jashtë saj pasqyrohej realiteti të cilin e jetonte populli shqiptar. Ajo borë e pakët që rrinte në maje mali, disi na e kujtonte dimrin e kaluar, mirëpo që ende nuk zhdukej, mbase donte t'tregonte se dimri tjetër do të vinte, ashtu siç është në të vërtetë dimri i ftohtë, e pothuajse i papërballueshëm. Shekujt mbanin mend njeri pas tjetrit historit e ndryshme të këtyre njerëzve, përpjekjen e vazhdueshme të ngjarjeve të cilat e ruajnë dhe e mbajnë kujtesën e tyre nën presionin e

dhimbjes, por dihej mirfilli se dikur kjo do të ndryshonte dhe shumë shpejte.....”

Çka mund t'më hyj në punë ky shkrim mendonte eprori. Megjithse kishte lexuar edhe disa të tillë, me dëshirë do të lexonte, edhe pse në këtë e nuhaste se diçka nuk shkonte por ishte kureshtar çka mund të shkruhej, koha ishte e shkurtër dhe shqyrtimi i dosjes duhej të përfundonte keshtu që mori dosjen e shkrimeve dhe e vendosi në raftë ngase duhej të përfundonte atë.

Që ti pushonte dhimbja e kokës mendoi të pinte një kafe, dhe para kësaj e piu një qetsues sepse dhimbja e kokës tani ishte thujtë rutinë.

Një cigare tjetër e ndezi dhe filloi të ecte nëpër zyre ndërkohë mendonte, se a kishte mundësi që me këto të dhëna të shkruate sado pak një raport përmbledhës. Fillimisht e shikoi tavolinën, pa se ende kishte dokumente të cilat duhej t'i shfletonte, fotografi, e shumë të tjera, çdo detaj duhej shikuar.

Kështu ia kishte komunikuar komandanti, sepse mund të ndodhte edhe e papritura që ai të shpëtonte, dhe për këtë flisnin faktet, e kaluara e kishte dëshmuar një gjë të tillë rreth Besim Ndreçës.

Sakaq një zhurmë nga larg u duk jo dhe aq e qartë, u mundua eprori të kuptonte se çfarë ngjau por nuk e lanë të të hynte në dhomë.

Pak nga pak e kuptoi se në atë dhomë fshihej diçka.

Dikush tha se aty brenda në stacion ishte një i plagosur nga Besim Ndrecaj dhe që nga momenti në moment pritej ta transportonin në spital.

Nga Radio-lidhja e një komandanti në koridor u dëgjua se Besim Ndrecaj ka plagosur një milic në Helikopter dhe se ende forcat speciale të milicisë nuk po mund të afrohen.

Beteja po vazhdonte. Rreth komandantit ishin edhe të tjerë të cilët nën ankth prisnin lajme nga beteja në fushat mes fshatrave Grejkoc e Malsi e re, ku qëndronte ende Besimi nën breshërin e plumbave nga forcat policore e ushtarake serbe.

Deri kur do të vazhdoj kjo, a dorzohet ky njeri: - u shpreh njëri nga ata i cili ishte afër komandantit serb, dhe si duket ishte këshilltari kryesor i tij për operacionin i cili s'kishte fund.

Të gjithë të vërejtur në fytyrë prisnin lajme nga lufta e cila ende zhvillohej.

Eprori u kthye në dhomën e tij. Pa orën e cila tashmë ishte afruar rreth pasdites dhe raporti duhej përfunduar, e kapi disi një panik. Vazhdoi me dokumentin e radhës i shkruar kohë më parë:

“Një dasëm shqiptare po zhvillohej sot. U menduam që kjo mos të na interesonte por, numri i njerzve ishte i madh, dhe ajo që na revoltoi ishte, flamuri i tyre kombëtar i cili valvitej në ballë të kolonës së njerzve. Pasi u konsultuam mes vete për një kohë të shkurtër, vendosëm që ti ndalim dhe t’ua marrim flamurin. Dhe kështu vepruam. Ashtu si herave tjera u paraqit personi për të cilin u kemi raportuar disa herë, pra Besim Ndrecaj i cili me vendosmëri ia ktheu flamurin dasmorve. Ne në fillim insistuam që kjo të mos ndodhte, por ai na theu në mënyrën e tij më të

vendosur. Kështu që duke marr parasysh rrethanat e jashtme e të brendshme se situata mund të eskalonte nga çasti në çast, vendosëm që t'ua lejojmë flamurin, edhe pse kjo iu dha zemër dasmorve dhe Besim Ndrecaj për ta u bë hero. Por ne mendojmë t'u sugjerojmë..."

Qeshi me ironi eprori dhe pëshpëriste me vete: rrethanat e brendshme e të jashtme na detyruan heheh, thuani qartë, u friguam nga ai dhe pikë, - bërtiti me zë të lartë, i mëshoi tavolinës saqë letrat u shpërndan gjithandej nëpër dhomë. Në çast u hap dera dhe në dhomë hyri një koleg i tij, hetues i kriminalistikës. E pa në gjendje kaosi eprorin të zverdhur në fytyrë e i trullosur nga tymi i cigareve të cilat kushedi sa e sa i kishte pirë.

- Çfarë ke keshtu, çfarë të ka ndodhur - e pyeti ndërkohë që vazhdoi me pyetje të tjera:

- Ti asnjëherë s'ke qenë kështu?, Pse ke humbur kaç keç?, Çfarë lënde po shqyrton?, Çfarë po ngjanë në këtë stacion.

- Ma sill një gotë ujë - iu përgjigj eprori.

Hetuesi ia solli, ai e piu vetëm pak e filloi të fliste.

- A mund të më bësh një nder, shkruaje këtë raport, se nuk jam mirë, jam tërësisht i çorjentuuar, veç aman mos i lexo të gjitha se të vret Besim Ndreca, Besim Ndreca të vret.... filloi të thërriste në mënyrë të pakontrolluar.

- Mos ulërij, je çmend - mundohej ta qetësonte Hetuesi, i cili habitej nga gjendja e tillë e kolegut të tij i cili e gjeti pothuajse të çmendur nga letrat e dosjet të cilat e rrethonin.

- A e njeh ti Besim Ndreçën, ai është madh, është shqiptarë i vërtetë - qeshej me të madhe eprori ndërkohë që hetuesi filloi të thërriste ndihmën kur e kuptoi se eprori nuk e kontrollonte më vehtën, dhe po fliste në mënyrë të pakontrrolluar.

Erdhën të tjerë milic, eprori tani vërtetë nuk kontrollohej. Ata u munduan ta lidhnin, e mblodhën disi në koridor, por me zë të lartë bërtiste:

“Pse po më lidhni mua, shkoni te Besim Ndreca, ai është duke ju pritur, shkoni, çfarë shikoni... - iu drejtua të mbledhurve në koridor të stacionit e të cilët shikonin në mënyrë të habitur.

- Çfarë ka ai? - e pyeti komandanti hetuesin.

Nuk e di, e gjeta mes dosjesh, i cili po fliste e qeshte me vete.

- Eja hyrë këtu te unë - e kapi për krahu Komandanti serb, i cili nuk donte që kjo të kuptohej nga të tjerët.

- Ai është çmendur komandant - i fliste me zë të dridhur e i hutuar hetuesi

E pashë, e pashë, - ofshante, dhe iu drejtua atij - kur do të përfundoj kjo ?

Nëse vazhdon deri nesër kjo do t'na çmend edhe neve.

Ora tashmë ishte afruar rreth 15 e 30 min. Radio-lidhja ushtonte, e kjo e theu heshtjen e cila ishte koncentruar pa e thënë nga askush se kështu duhej të ndodhte.

Menjëherë Komandanti u mor me këtë dhe filloi :

- Marrje, marrje, çfarë lajme keni, si është situata?

Po Komandant, Besim Ndreca u vra - dëgjohej zëri nga radio-lidhja.

Komandanti serb lëshoi frymën, shpërthakoi këmishën, e të tjerët me sy e veshë drejtuar kah ai, dëgjonin me vëmendje.

Nga radio-lidhja dëgjohej: - pas disa orëve më në fund jemi afruar dhe tani gjendemi pranë tij.

- Ai ka vararë vetën, e nuk është dorzuar, edhe pse me orë të tëra siç ju kemi informuar jemi munduar që ta zëmë të gjallë por...

- Në rregull u kuptuam - e ndërpreu lidhjen, e më pas ju drejtua milicëve.

- Kjo punë mbaroi me kaç! duhet të arrestohen të gjithë ata që e kanë njohur më mirë, të familjes e të tjerë. Kush është arrestuar deri më tani? - i pyeti milicët.

Vëllau i tij e të tjerë që priten të arrestohen - foli njëri nga milicët.

- Mirë shumë, veproni sipas listës për arrestime të cilën e kemi përpiluar - urdhëroi Komandanti.

Ndërkohë iu afrua hetuesi dhe filloi ta këshillonte atë:

- komandant do t'ju këshilloja të mos nguteni sepse tani është kaos, e ...

- Ti, shko në zyrën e eprorit tënd e ma sjell gjithë dosjen këtu, - filloi ti fliste me ironi komandanti dhe vazhdoi me porosi - pastaj shko e shihe atë në spital e ne takohemi ta bëjmë raportin bashkë, se ai më duket tash nuk është më për këtë punë.

Të gjithë filluan të largohen e njëri nga milicët pyeti kolegun e tij disi fshehtas.

Interesant askush su gëzua, e çuditshme ehh, po sikur të vazhdonte deri neser, por sidoqoftë kjo do të mbetet

gjatë si ngjarje e paharruar - ia priti tjetri i cili e shoqëronte deri në oborr.

Në dhomën e eprorit i cili kishte kontrolluar dosjet mbledhite letrat, fotografitë etj, hetuesi që si duket e mori detyrë të re .

Dera u mbyll, e dritarja u hap. Në dhomë hyri ajri i lirë, ngadalë shfletonte edhe dosje të tjera, kish shumë për të kërkuar koha, asgjë si duket s'kishte përfunduar.

Dhoma e shëndrruar në burg dosjesh siç e mendonte eprori dikur tani era do t'i jep kuptim të ri!

Ato dosje do të shpërndaheshin nga burgu i letrave e heshtja e thyer do të bëhej zëri që do të flas!

*

* *

Lajmi mbi rastin e 3 majit 1995, kishte pushtuar çdo gjë. Kudo tashmë flitej për Besim Ndrecën. Që nga rrugët ku njerzit flisnin me njëri-tjetrin për këtë ngjarje, dhe jepnin versione nga më të ndryshmet, e deri tek milicët të cilët në çdo pore të jetës kishin instaluar mundësinë që kushdo mund të torturonte shqiptarët.

Kjo ishte përditshmëri për pushtetin i cili maltretonte e shtypte mundësinë e jetes se shqiptarëve, mirëpo ngjarja e fundit tregoi se kjo nuk do të vazhdoj dhe shumë gjatë.

E gjithë kjo kishte vën në funksion mekanizma të ndryshëm, ngase mund shqyrtoj mundësi që ngjarja si kjo e fundit mund të përsëritej dhe ky system të kishte ditët e numëruara.

Kjo natyrë e bisedës në forma të ndryshme, zhvillohej mes komandantit dhe hetuesit, i cili ishte kolegu dhe shoku më i ngushtë i eprorit.

Mes diskutimesh të tjera komandanti e filloi bisedën për gjendjen shëndetsore të eprorit: - isha sot në mëngjes në spitalin psikiatrik, e takova dhe qëndrova pak minuta me te. U brengosa shumë kur e pashë në atë gjendje. Fliste në mënyrë të paqartë për dosjet, qante, bërtiste.

- A ke ndonjë lajm për të? - e pyeti komandanti dhe i ofroi një cigare.

Hetuesi e pa cigaren disi me dyshim dhe me dy mendje vazhdoi disa sekonda, ja mori dhe deri sa e sillte nëpër gishta e filloi rrëfimin për eprorin: - Atë e kam njohur gjatë studimeve në Beograd. Ishte student i zoti. Kur e caktuan me detyrë për në Kosovë nuk i kishte pëlqyer kjo gjë saqë njëherë kur kemi pirë kafe ai më sqaronte se këtë punë nuk dëshironte ta bënte këtu.

E njohë si lexues të apasionuar të librave të Historisë por edhe të degës tonë të cilën ne e punojmë. Nganjëherë them se mund të vijë në përfundim se ndoshta ky lexim përnjëherë në të njëjtën kohë i këtyre drejtimeve shkencore ka bërë që ai të devijojë mentalisht.

Por më intereson gjithnjë e më tepër se çfarë e ka ngacmuar në trurin e tij, cila ishte ajo ngjarje?

Komandanti ia ktheu: - ai ka pasur disa detyra si kjo e fundit, por mund të ketë ndodhur që ngjarja e fundit ka qenë me më shumë tension apo s'është kështu ?

Unë dje e vizitova vetëm një herë përderisa ai punonte ngase kisha edhe unë punë - shprehej si në arsyetim Hetuesi dhe sqaronte:

- E pash që ishte i zbehtë e i friksuar, por s'munda të bisedoj ngase kisha pak kohë. Pasi e quan në spital, dhe u qetësua pak më bënte pyetje: - e kanë vrarë apo është në stacion, aludonte në Besim Ndrecën.

E kisha të vështirë ta kuptoja se, pse friksohej kaq shumë nga ai, atë se ka parë asnjëherë, largë betejës ishte dje, apo se ka përballuar ndoshta betejën e letrave.

Komandanti e vështronte me cinizëm Hetuesin dhe ky i fundit e kuptoi se duhej të ndërpriste sqarimin dhe për këtë e pyeti disi me ndrojtje:

- Kur duhet ta dorzojmë raportin?

- Nesër më së largu, por duhet ta lexosh këtë edhe pse është e shkruar shkurtimisht, besoj se të ndihmon në përpilimin dhe përfundimin e plotë të raportit. Kjo dorzohet nesër ashtu siç të thash më parë. Në media asgjë s'duhet të dalë, edhe pse është paraqitur nga pakë, por edhe ajo është ndërprerë, besoj se më kuptove.

Dosjen a e ke lexuar mbrëmë?- e pyeti ndërkohë komandanti.

Po, shumë shpejtë, sepse më ndihmuan edhe shënimet e eprorit, i cili kishte shkruar gjatë shqyrtimit të tyre. Por desha t'ju pyes edhe diçka, nga autopsia kuptova se Besim Ndrecaj kishte vrarë vehtën, dhe jo siç është deklaruar se e ka vrarë milicia, pastaj e kam të paqartë edhe vrasjen e milicit në Helikopter. Si ta shkruaj këtë,

kam në disponim pak kohë, nuk është e mjaftueshme duke pas parasysh ngjarjen.

Ti sonte i përfundon të gjitha ato që t'i thash, mi dorzon mua nesër në mëngjes dhe të shohim se si do shkoj varrimi i tij nesër. Kam përshtypjen se do të marrin pjesë shumë njerëz, kjo do të jetë shumë e dëmshme për ne, sepse do ta bëj atë hero.

T'ju them edhe diçka gjë për të cilën dëshiroj ta ndaj me ju në rrafshin shoqëror. Urdhëroni, vetëm urdhëroni - i tha në shenjë përkrahje hetuesi.

Fërkoi sytë, ofshani e më pas vazhdoi - Mbrëmë nuk kam fjetur aspak, edhe nëse mund të kem fjetur sadopak në ëndërr pash vetëm skena lufte, pas atij Besimit mu duk sikur vinin qindra e mijra ushtarë, të cilët luftonin kundër nesh. E tmerrshme disa herë jam zgjuar nën ankth.

Hetuesi e shikoi dhe me padurim filloi të fliste edhe ai:

- Vërtet komandant, pasi i lexova dosjen dhe e pash kufomën e tij, ende kam frikë nga ai. Diçka po ndodh, e kam përshtypjen se nuk po vjen kohë e mirë, desha që me shkrim t'ju kërkoja t'më transferoni në Beograd, besoj se do t'më ndihmonit. Nuk dua t'më ndodh si eprorit në spital.

- Ju lutem, atje kam edhe familjen e cila më pret.

Komandanti e shikoi, e ndezi një cigare, dhe filloi të fliste me zë të ulët:

- Të gjithë ndoshta një ditë do të ikim ! tani mund të shkoni.

Hetuesi e kuptoi situatën, mblodhi të gjitha dosjet dhe u largua nga zyrja e Komandantit. Ecte nëpër koridor,

çdo 3 hapa ndalej dhe vazhdonte, deri sa arriti në zyrën e tij.

Me kureshtje po lexonte dokumentin me përmbledhjen e ngjarjes së djeshme:

“04. 5. 1995 - Dje me datë 03. 5. 1995, Komandanti i stacionit tonë Dragan Shoshkiq, ka marrë për detyrë që të shkojë tek personi i shumëkërkuar Besim Adem Ndrecaj i lindur me 10 maj 1956, në fshatin Maqitevë të Suharekës, nën preteksitin e konfiskimit të armës. Fillimisht patrulla jonë ka shkuar në shtëpinë e tij në Malsi të re rreth orës 9:00, por familja u ka informuar se ai gjendet në vendin e tij të punës në ndërmarrjen OBI-Suahreka. Më pas Shoshkiq dhe milicët e tjerë kanë shkuar tek vendi i tij i punës duke njoftuar edhe njësitë e tjera të milicisë në Suharekë. Sapo kanë arritur aty i kanë njoftuar rojet për akcionin ngase kanë qenë në dijeni se personi në fjalë Besim Ndrecaj bartë armë me vete. Atë e kanë gjetur me kolegë të tjerë në vendin e punës duke festuar në një zyrë pune, daljen e njërit prej punëtorve në pension. Shoshkiq e ka kërkuar me emër dhe ai është përgjigjur, dhe më pas është kërkuar nga punëtorët që ta lëshojnë zyrën, dhe më pas ata kanë dalë. Në mënyrë të befasishme vepron Besim Ndrecaj duke e nxjerr revolen e tij dhe e vret komandantin Dragan Shoshkiq dhe plagos rëndë Dragan Dobrosavleviqin zv.Komandant në Stacionin e Milicisë në Suharekë, ndërkohë që ende nuk kemi informacione për të tjerët. Ai është larguar me shpejtësi nga ai vend dhe sipas informacioneve që i posedojmë ai ka strehuar familjen e tij në fshatin Greikoc ku më pas është

ballafaquar me forcat tona policore e ushtarake duke mos u dorzuar derisa është vrarë. Ne ende vazhdojmë kërkimet tona rreth motivit dhe mundësive të tjera që kjo ngjarje të prodhoj destabilitet në rajonin tonë. Ndër të tjera vlen të përmendet..."

* * *

Sapo e përfundoi së lexuari këtë raport të shkurtër, të cilin duhej ta plotësonte, në zyre hyri Komandanti ku i dha një urdhër.

Nesër varroset ai, dhe kemi informacione të sakta se ka interesim të madh të shqiptarëve që të marrin pjesë në pjesën mortore të varrimit të tij, ti duhet të jesh atje me eprorët e tjerë, në mënyrë që ta përcillni situatën nga afër dhe për çdo eventualitet apo situatë tjetër më njoftoni menjëherë. E qartë - bërtiti me zë të lartë.

- E çartë - iu përgjigj eprori.

- Dhe harrova edhe diçka - u kthye komandanti para se të mbyllte derën - Kërkesa juaj për transferim do të shqyrtohet javën tjetër. Përplasi derën saqë ia futi të dridhurat Hetuesit.

Në këtë moment i kishte ndjenjat e përziera.

E gëzoi fakti se do të transferohej, por nuk e kuptoi frikën nga brenda, duke pas në kujtesë faktin se edhe ai do të ishte në varrimin e Besim Ndrecës.

Kur do të përfundoj kjo, apo siç duket jemi të dënuar, që të frigohemi edhe nga hija e tij, la dosjen dhe iku nga zyra. Sidoqoftë, nesër ai do të ishte atje, në varrimin e Heroit.

*

* *

Qysh në orët e para të mëngjesit, populli ishte drejtuar për ta takuar ajrin ku tashmë mbante erën e barutit, nga beteja e ditëve të mëparshme ku Heroi e poshtëroi robërinë, e na dha shembullin dhe mënyrën se si mund të fitohej dinjiteti disa herë i nëpërkëmbur. Kudo ishin rrugët e mbushura me njerëz të ardhur nga të gjitha viset Shqiptare drejt fshatit Malësi e re, të takonin shembullin e burrërisë shqiptare.

Në fytyrat e njerzve shihej pikëllimi, për njeriun e mirë e të sigurtë, për njeriun e besës, ku këmbëkryq rrinte i heshtur në odën shqiptare dhe mbante mend urtësinë e plakut pranë oxhakut dikur.

Për burrin i cili në madhësinë e tij, se njeh jetën e të burgosurit, e hija e tij zgjatet aq sa e tmerron armikun kudo.

Malet ja dëgjuan krismën e revolës, e përshëndetën dhe e bartën me vete ushtimën duke e kaluar bjeshkë më bjeshkë e shkrep më shkrep, lajmin e hakmarrjes që kudo pritej, kudo tashmë dëgjohej.

Më lirshëm do të ecnin rrugëve, me lirshëm do të frymonim, duke mbajtur mend kushtrimin e betejës ku Heroi dha shembullin e sakrificës e të përjetësisë.

Në sytë e njerëzve tashmë lexohej, motivi për të luftuar, mundësia për ta jetuar jetën më mirë, forca se tash armiku mund të jetë i thyeshëm, guximi gjithshu për të vepruar.

Nëse dikur, dikush mendonte se revolja nuk shkrep për milicinë serbe që ka mjet terrorin e shtypjen për

shqiptarët, e cila nën pretekstin e kërkimit të armëve maltreton e poshtëron dinjitetin e tyre, tani sigurisht se gjykon që kjo përfundimisht duhet të ndalet.

Fundi i epokës së nënshtrimit kishte filluar tashmë numrimin e kohës kur pushteti i egër në tokën e huaj duhej përfundimisht të largohej.

Të vjetër e të rinjë në moshë, që mbanin mend format e ndryshme të poshtërimit nga okupimi serb, do ta mbanin mend gjatë e s'do të harronin sakrificën dhe shembullin e Heroit Besim Ndreca.

*

* *

Era me ushtimën e saj erdhi, ju dha maleve dëshirën e kahmotshme që luftëtarët të marshonin në to, dhe gjithsesi të jetësonin përpjekjen e gjithë brezave ku gjyshi e stërgjyshi iu kish lën amanet.

Krisma e revolës së Besim Ndreçës ju dha zemër mijëra luftëtarëve të nishin betejën që koha e donte, për aq sa ishte e pashmangshme, ishte bër tashmë sinjali i paralajmëruar.

Ata e kishin kuptuar domosdoshmërinë për ta vazhduar atë që e kishte dikur synim e ideal Besim Ndrecaj dhe të tjerët si ai.

Kështu nisi përpjekja e kahmotshme që përkushtimin për lirinë e ëndërruar ta bënin realitet. Ishte shembulli i tij, që iu kishte treguar të gjithëve me entuziazëm e vendosmëri që vendit i duheshin marshime luftëtarësh, i duheshin të guximshmit të cilët se njohin frikën e përpara shohin mundësin gjithnjë e më shumë për ta

përballuar edhe më të fuqishmën, që pandalshëm të vazhdonin, deri në fitore.

E përjetuam atë që historia njerëzore e kishte paralajmëruar shekuj më parë, se armiku është pothuajse i njëllajt gjithkund, ai ka metoda të ndryshme të realizoj udhëtimin e tij grabitqar të zakonshëm atë të pushtimit.

Koha tregoj dy palët e një lufte të paralajmëruar, të domosdoshme, të pashma - ngshme sepse ishte e vetmja mundësi për të egzistuar së pari.

Populli se harroi mundin e sakrificen e njeriut, i cili në kohën më të vështirë ia ktheu dinjitetin atij.

Sot, asnjë kalimtar nuk mundet të kaloj aty pari pa vën re shtatoren e tij.

Tërheq vëmendjen e secilit sepse natyra dhe paraqitja e tij është madhështore. Ai është frymëzimi i secilit nga ne kur duam t'ia caktojmë vendosmërinë vehtës.

Është përgjigjja e pyetjeve të cilat na paraqiten kur kemi dilema e dukemi të pasigurtë, ai është shembulli për njerzit të cilët nuk duan që asgjë ti ndal përpara.

Në pranëverë kur lulet e bukura japin freski dhe bari i gjelbër i jep kuptim fillimit të bukurisë në natyrë, shtatorja u bën roje.

Në verë kur fëmijët luajnë dhe lojrat e tyre mbesin, çdo ditë në pushimet e tyre të verës, apo kur në shkollë vijnë mësimin, shtatorja duket para tyre t'u jep zemer në lojë.

Në vjeshtë kur gjyshi e nipi shëtisin në këtë shesh ata flasin dhe nipi e dëgjon me vëmendje gjyshin e tij tek i flet për trimërinë shqiptare, aty është shembull

shtatorja, është e lehtë për gjyshin sepse për nipin ka shembull për këtë.

Në dimër kur të ftohtit dhe dëbora mbulojnë gjithçka dhe ne të gjithë futemi brenda në vatrat tona, jashtë në shesh është ai, stoik dhe i palëkundur na bën roje.

Ai është jashtë dhe brenda nesh, kudo na jep zemër, na jep motiv, sepse ai është i veçantë, ai është HERO.

Brahim Thaçi

=====

© Pashtriku.org, Dhjetor 2012

=====